

**RAPORT MBI GJENDJEN E TË DREJTAVE TË TË
MITURVE NË INSTITUCIONET E PARABURGIMIT DHE
TË EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE PENALE
GJATË PERIUDHËS TETOR - DHJETOR 2009**

Vëzhgimi është kryer në kuadër të programit të reformës së drejtësisë për të miturit, mbështetur financiarisht nga UNICEF, EC dhe SIDA. Gjetjet e këtij raporti janë të KSHH-së dhe jo domosdoshmërisht paraqesin qëndrimin zyrtar të organizatave mbështetëse

Përmbajtja

- I. Përmbledhje ekzekutive**
- II. Qëllimi i vëzhgimeve, baza ligjore dhe metodologjia e përdorur**
- III. Situata në institucionet e vëzhguara**
- IV. Disa sugjerime për përmirësimin e respektimit të të drejtave dhe trajtimit të të miturve**

I. Përmbledhje ekzekutive

Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH), në përmbushje të misionit të tij për mbrojtjen, edukimin dhe sensibilizimin e opinionit publik dhe të organeve shtetërore për një respektim më të mirë të të drejtave të shtetasve, realizoi gjatë muajve Tetor -Dhjetor 2009 vëzhgime në institucionet e paraburgimit dhe në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, të cilët kanë seksione për mbajtjen dhe trajtimin e të miturve të tilla si 'Jordan Misja' në Tiranë, I.E.V.P. Korçë, I.E.V.P. Lezhë, I.E.V.P. Vaqarr¹, I.P. Durrës dhe I.P. Vlorë. Vëzhgimet u realizuan nga vëzhgues me përvojë të KShH-së. Qëllimi i vëzhgimeve ishte vlerësimi i situatës së të drejtave të të miturve të paraburgosur ose të dënuar. Gjatë vëzhgimeve u mbajtën parasysh standardet, të drejtat dhe rregullimet e përcaktuara në legjislacionin kombëtar dhe atë ndërkombëtar. Vëzhguesit morën takime të drejtpërdrejta me të gjithë të miturit e paraburgosur dhe të dënuar, si dhe takime me drejtues të niveleve të ndryshme të institucioneve të vëzhguara. Vëzhguesit patën mundësi të hyjnë pa probleme apo vonesa në këto institucione, ndaj gjejmë rastin të falenderojmë personelin drejtues të këtyre institucioneve për lehtësimin e kryerjes së vëzhgimeve dhe për vënien në dispozicion të ambienteve dhe dokumentacionit të nevojshëm. Kjo tregon për një qasje të hapur të drejtimit të këtyre institucioneve, e cila lë hapësirë për përmirësime të vazhdueshme të shërbimeve të sistemit të burgjeve shqiptare.

Nga vëzhgimet rezultoi se në përgjithësi vihet re një ndërgjegjësim më i lartë i personelit në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve (DPB) dhe në institucionet lokale të vëzhguara sa i takon trajtimin e të miturve. Për t'u vlerësuar është hapja e institucionit të ri-integrimit në Kavajë, si dhe ndryshimet pozitive të arritura lidhur me infrastrukturën e përmirësuar të institucioneve ku qëndrojnë të miturit. Në të gjitha institucionet e vëzhguara, të miturit qëndronin në sektorë të veçuar nga të rriturit, çka tregon për një qasje që përfshin një kujdes të veçantë që i ofrohet kësaj kategorie.

Ajrimi, si një e drejtë bazë, ofrohej me orare më të zgjatura për të miturit, megjithatë u hasën probleme me ambientet jo të përshtatshme të kryerjes së ajrimit, si edhe në disa raste të miturit e kryenin ajrimin bashkë me të rriturit. Kushtet higjieno- sanitare në këto institucione ishin të mira në përgjithësi, megjithatë u konstatuan probleme të lagështirës në disa nga institucionet e vëzhguara, si edhe një amortizim i lartë i pajisjeve për fjetje.

Në përgjithësi norma ushqimore zbatohet dhe të miturit nuk paraqitën ankesa në lidhje me cilësinë dhe me kushtet higjieno-sanitare të përgatitjes së ushqimit. Megjithatë, duke qenë se praktika e sjelljes së ushqimeve nga familjarët përbën problem për sigurinë në institucione dhe ngarkesë për personelin, KShH sugjeron të zëvendësohet me masa alternative, si funksionimi normal dhe me larmishmëri artikujsh në dyqanet brenda institucionit si dhe me inkurajimin e familjarëve për vendosjen e vlerave monetare në numrat e llogarive të të miturve për t'u përdorur nga këta të fundit për nevojat e tyre për artikuj të ndryshëm ushqimorë.

Shërbimi shëndetësor paraqitet në nivele normale në përgjithësi, megjithatë u hasën ndryshime nga institucioni në institucion. Mbetet ende shqetësues fakti që nuk realizohen ekzaminime mjekësore për të miturit në momentin e hyrjes së tyre në institucion. Ndërsa

¹ Vëzhgimi në I.E.V.P. Vaqarr është kryer në kuadër të projektit 'Së bashku për trajtimin me respekt të të drejtave të personave të privuar nga liria', financuar nga Komisioni European, por duke qenë se ky vëzhgim përfshin sektorin e të miturve është përfshirë në këtë raport.

shërbimi stomatologjik mbetet ende problem sa i takon mungesës së pajisjeve, medikamenteve stomatologjike, si dhe cilësisë së ofruar.

Informimi i të drejtave në momentin e ndalimit ose të arrestimit vazhdon të jetë problem shqetësues. Shumë prej të miturve të paraburgosur të intervistuar, pretendonin se nuk u ishin bërë të ditura të drejtat e tyre në momentin e arrestimit. Nuk u ishte vënë në dispozicion një avokat edhe pse e kishin kërkuar një të tillë. Pothuajse të gjithë të miturit e intervistuar pohuan dhunë fizike dhe psikologjike të ushtruar nga punonjësit e policisë dhe policisë gjyqësore në momentit e ndalim/arrestimit dhe marrjes në pyetje si edhe mohimin e të gjitha të drejtave procedurale të sanksionuara në legjislacionin shqiptar. Për më tepër, organet e prokurorisë dhe të gjyqësorit nuk kishin marrë masa për ndjekjen e rasteve kur pretendohet nga i mituri dhunë e ushtruar ndaj tij dhe vënien para drejtësisë së personave përgjegjës.

E drejta e informacionit dhe e ushtrimit të riteve fetare, në institucionet e vëzhguara nga KShH-ja, në përgjithësi zbatohet. Duke pasur parasysh rëndësinë e trajtimit nëpërmjet programeve psiko-sociale, edukuese dhe rikrijuese në grup dhe trajtimin individual, KShH i dha një rëndësi tejet të madhe vëzhgimit të programeve të ofruara në institucionet e vëzhguara. Vlen të theksohet së gjendja ndryshonte nga institucioni në institucion. Mungesa e programeve rikrijuese, sportive e argëtuese u verejtën në disa nga institucionet e vëzhguara. Pavarësisht mungesës së ambienteve të veçanta, nuk mund të justifikohet mungesa e aktiviteteve sportive qoftë një herë në javë për të miturit, apo e aktiviteteve të tjera rikrijuese të cilat janë një element i rëndësishëm i trajtimit të këtij grupi në institucionet penale. Vetëm të miturve në institucionin e Korcës u ofroheshin kurse arsimore, në zbatim të marrëveshjes midis Ministrisë së Drejtësisë dhe asaj të Arsimit dhe Shkencës, ndërsa në institucionet e tjera të vëzhguara kjo marrëveshje ende nuk kishte gjetur zbatim. Në kuadër të punës për ri-integrimin e të miturve në shoqëri pas lirim, duhet bërë një punë më profesionale me qasje individuale me të miturit nga sektorët e kujdesit social në institucionet penale dhe organet e tjera publike përgjegjëse për rikthimin e të miturve në shoqëri. Vlen të theksohet se nga punonjësit e sektorit të kujdesit social të institucionit të Durrësit u ngrit problemi i mospranimin të të miturve nëpër shkollat nga të cilat ata vinin, pas lirim të tyre. Pavarësisht përpjekjeve të vazhdueshme nga ana e këtij institucioni, kjo gjë nuk kishte gjetur ende zbatim.

Në përgjithësi rezultoi se nuk ka pasur raste flagrante të përdorimit të dhunës ndaj të miturve, megjithatë kishte disa pretendime sporadike të cilat mbetën të vështira për t'u verifikuar. Pavarësisht këtij fakti, KShH tërhoq vëmendjen e drejtuesve të institucioneve penale dhe të DPB-së që të shqyrtojnë nga afër këto pretendime për parandalimin e rasteve të përdorimit të dhunës dhe të keqtrajtimit ndaj të miturve.

Në pjesën më të madhe të institucioneve të vëzhguara nuk ka ambiente të përshtatshme për takimet e të miturve me familjarët, që të mundësojnë kontaktet fizike mes tyre. Duke pasur parasysh sesa e rëndësishme është lidhja me familjen, për të miturit në institucionet penale, duhet të shihet me përparësi forcimi i këtyre marrëdhënieve.

KShH ka dhënë mbështetje të vazhdueshme dhe ekspertizë nëpërmjet praktikave të mira për një pjesë të personelit të sektorit të kujdesit social të institucioneve të ndryshme penale, nga i cili ka marrë premtimin se do të hartohen plane konkrete për trajnim e personelit të institucioneve ku ka të mitur. Nga sa rezultoi prej vëzhgimeve, ende nuk ekziston praktika e trajnimeve vazhduese të personelit me uniformë, të cilat do të përmirësonin klimën e të ndjerit të sigurt në institucione dhe do të mundësonte një trajtim më të mirë të të miturve.

Raporti del me sugjerime konkrete për situatën e të drejtave dhe trajtimin e të miturve në konflikt me ligjin të cilat do t'i gjeni më poshtë.

II. Qëllimi i vëzhgimeve, baza ligjore dhe metodologjia e përdorur

1. KShH-ja organizata e parë e të drejtave të njeriut e krijuar në vitin 1990 ka për mision mbrojtjen, edukimin dhe sensibilizimin e opinionit publik dhe të organeve shtetërore për një respektim më të mirë të të drejtave të shtetasve. Monitorimi i respektimit të të drejtave të personave të arrestuar, të paraburgosur dhe të dënuar është një nga fushat kryesore të vëzhgimeve të KShH-së.
2. Gjatë periudhës Tetor - Dhjetor 2009, KShH realizoi vëzhgime në institucionet e paraburgimit dhe në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, të cilët kanë seksione për mbajtjen dhe trajtimin e të miturve. Më konkretisht u vëzhguan institucionet e paraburgimit: 'Jordan Misja' në Tiranë, I.E.V.P. Korçë, I.E.V.P Lezhë, I.E.V.P Vaqarr, I.P. Durrës dhe I.P. Vlorë. Këto vëzhgime u kryen në kuadër të projektit "Për një respektim më të mirë të të drejtave të të miturve në institucionet penale" mbështetur nga UNICEF, Tiranë dhe financuar nga SIDA dhe Komisioni Evropian.
3. Qëllimi i vëzhgimeve ishte vlerësimi i situatës së të drejtave të të miturve të paraburgosur dhe të dënuar që qëndrojnë në institucionet penale.
4. Gjatë vëzhgimeve u mbajtën parasysh standardet, të drejtat dhe rregullimet e përcaktuara në legjislacionin shqiptar më konkretisht në Kushtetutën e R.SH-së, Kodi e Procedurës Penale, Ligji nr. 9331, datë 21.04.1998, ndryshuar me ligjin nr. 10024, datë 27.11.2009, 'Për ekzekutimin e vendimeve penale', ligji nr. 9888, datë 10.03.2008, 'Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8328, datë 16.04.1998, 'Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim', i ndryshuar dhe rregullorja e përgjithshme e burgjeve. Rekomandimet e Komitetit për Parandalimin e Torturës të Këshillit të Evropës për Shqipërinë, rekomandimet e Avokatit të Popullit dhe të KShH-së u mbajtën gjithashtu parasysh.
5. Gjatë vëzhgimeve u morën takime të drejtpërdrejta me të miturit e paraburgosur dhe të dënuar, takime me drejtues të institucioneve të vëzhguara, përgjegjësit dhe specialistët e sektorëve të sigurisë, të kujdesit social dhe sektorit juridik, shëndetësorë dhe të personelit. Vëzhgimet u realizuan nga vëzhgues me përvojë të KShH-së me profesion juristë, mjekë, psikologë dhe punonjës socialë.
6. Raporti paraqet problemet më të përgjithshme të konstatuara në institucionet e vëzhguara. Gjatë vëzhgimeve, vëzhguesit e KShH-së patën mundësi të hyjnë pa probleme apo vonesa në këto institucione, të marrin takime me të paraburgosurit dhe të dënuarit dhe të komunikojë lirshëm me ta, të vëzhgojnë ambientet e ndryshme të institucioneve dhe të shqyrtojnë dokumentacionin përkatës, ndaj gjejmë rastin të falenderojmë personelin drejtues të këtyre institucioneve për lehtësimin e kryerjes së vëzhgimeve dhe për vënien në dispozicion të ambienteve dhe dokumentacionit të nevojshëm. Kjo tregon për një qasje të hapur të drejtimit të këtyre institucioneve, e cila lë hapësirë për përmirësime të vazhdueshme të shërbimeve të sistemit të burgjeve shqiptare.

III. Situata në institucionet e vëzhguara

7. Në përgjithësi vihet re një ndërgjegjësim më i lartë i personelit në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve dhe në institucionet lokale të vëzhguara sa i takon trajtimin e të miturve. KShH ka ofruar ekspertizë lidhur me qasjen e trajtimin e të miturve, nëpërmjet dy projekteve të financuara nga UNICEF Shqipëri, duke i kushtuar vëmendje të veçantë trajnimit të personelit që punon me të miturit dhe për programet që duhen zbatuar me këtë grup në pozita të dobëta në burgjet shqiptare. Megjithëse ky raport përqendrohet tek trajtimi i të miturve, vlen të theksohet se ka një vëmendje të veçantë kushtuar edhe të rinjve të moshës 18-21 vjeç për të cilët janë hapur sektorë të veçantë sipas urdhrit të Ministrit të Drejtësisë. Për t'u vlerësuar është hapja dhe vënia në funksionim i institucionit të ri-integrimit në Kavajë në muajin Tetor 2009. Ky institucion përmbush kushtet infrastrukturore për një trajtim sa më të larmishëm dhe bashkëkohor, me programe specifike individuale dhe në grup për të miturit që do të kryejnë dënimin aty.
8. Duke vlerësuar ndikimin që ka infrastruktura dhe kushtet fizike të institucioneve të paraburgimit në respektimin e të drejtave të njeriut dhe në ofrimin e shërbimeve ndaj tyre, KShH-ja vlerëson ndryshimet pozitive të arritura sa i takon infrastrukturës së përmirësuar të institucioneve ku qëndrojnë të miturit, si edhe trajtimin e veçuar që i ofrohet këtij grupi në pozita të dobëta në burgjet shqiptare. Në të gjitha institucionet e vëzhguara të miturit qëndronin në sektorë veçuar nga të rriturit, çka tregon për një qasje që përfshin një kujdes të veçantë që i ofrohet kësaj kategorie. Vlen për t'u nënvizuar situata në institucionin e paraburgimit në Vlorë, kushtet fizike infrastrukturore të së cilit plotësonin nevojat për çdo shërbim që ofrohej ndaj të miturve. Megjithatë, probleme me infrastrukturën u vërejtën në disa institucione si ai i Korçës dhe i Durrësit, në të cilët mungesa e një ambienti të veçantë për ajrimin për të miturit krijonte një mosfunksionim të mirë të ushtrimit të kësaj të drejte. Gjithashtu, në këto institucione mungonin ambientet për realizimin e aktiviteteve sportive për të miturit të cilët marrin një rëndësi tejet të madhe veçanërisht për zhvillimin e tyre.
9. Nga vëzhgimet e kryera, rezultoi se të miturve të paraburgosur u rezervohet një trajtim i veçantë për sa i takon ajrimin. Në shumicën e institucioneve të vëzhguara të miturit dilnin në ajrim veçmas nga të rriturit dhe/ose në orare të ndryshme. Në përgjithësi, orari i ajrimin për të miturit ishte më i zgjatur në krahasim me atë për të rriturit. Megjithatë, në ndonjë institucion si ai i Korçës, të miturit kishin mundësi kontakti me të rriturit gjatë kohës së ajrimin për arsye se mungonte një ambient i veçantë për ajrimin e të miturve. Për më tepër të miturit dilnin në ajrim në orare kur dilnin edhe të rriturit. Kjo është një shkelje të së drejtës për ajrim të veçuar nga të rriturit. Një tjetër problem i konstatuar sa i takon ajrimin ishte fakti se gjatë ditëve me kushte të këqija klimaterike të miturit nuk mund të dilnin në ajrim sepse nuk kishte një tendë mbrojtëse ndaj shiut apo erës². Në këtë mënyrë institucionet, përveç

² Ky ishte një problem prezent thajse në të gjitha institucionet e vëzhguara dhe nga intervistat me personelin, u konstatua se investimi për tenda të tilla e kalonte shpenzimin e lejuar nga institucioni. Ai hynte në zërin e shpenzimeve "Investime" dhe ishte DPB që e mbulonte këtë zë.

institucionit të Lezhës ku ky problem ishte zgjidhur tashmë, nuk mund të përmbushnin detyrën e krijimit të kushteve të përshtatshme për ushtrimin e të drejtës së ajrimit, gjë e cila përbën shkelje të kësaj të drejte.

10. Një tjetër objekt i vëzhgimeve të KShH-së ishin kushtet higjeno-sanitare të institucioneve, të cilat ishin të mira në përgjithësi. Megjithatë, u konstatuan probleme të lagështirës në të gjitha institucionet e vëzhguara, si edhe një amortizim i lartë i pajisjeve për fjetje. Dyshekët, batanijet, çarçafët, etj. ishin të amortizuara. Të miturit që kishin mundësi, i siguronin ato nëpërmjet familjes. Mungesa e ujit gjatë 24 orëve, e detergjenteve dhe e pajisjeve të tjera të higjienës, shpeshherë bëhej problem për mbajtjen pastër të dhomave dhe të ambienteve të përbashkëta. Në institucionin e Lezhës të gjitha godinat, si ato të administratës, ashtu edhe ato të qëndrimit të të paraburgosurve dhe të dënuarve, ishin me shumë lagështirë dhe me mure të prishur. Po ashtu në institucionin 'Jordan Misja' dhe në atë të Korçës rezultoi i njëjti problem. Mungesa e ngrohjes ishte një tjetër problem prezent i evidentuar në pothuajse të gjitha institucionet, jo vetëm për të miturit e paraburgosur e të dënuar, por edhe për personelin që punonte në këto institucione.
11. Në përgjithësi norma ushqimore zbatohet dhe të miturit nuk paraqitën ankesa në lidhje me cilësinë e ushqimit dhe me kushtet higjeno-sanitare të përgatitjes së tij. Në përgjithësi ushqimi konsumohej, ndonëse të miturit përdornin edhe ushqime të sjella nga familjarët. Sjellja e ushqimeve nga familjarët është një praktikë e burgjeve shqiptare e cila krijon premisa që të cenohet siguria në institucione, si dhe angazhon personelin me uniformë për kontrollin e tij. Kjo praktikë sugjerohet të zëvendësohet me masa alternative, si funksionimi normal dhe me larmishmëri artikujsh në dyqanet brenda institucionit, si dhe me inkurajimin e familjarëve për vendosjen e vlerave monetare në numrat e llogarive të të miturve për t'u përdorur nga këta të fundit për nevojat e tyre për artikuj të ndryshëm ushqimorë.
12. Shërbimi shëndetësor paraqitej në nivele normale në përgjithësi, megjithatë u hasën ndryshime nga institucioni në institucion. Të gjithë të miturit ishin të pajisur me kartelën e tyre shëndetësore. Në institucionin e paraburgimit të Vlorës ishte hartuar një program i veçantë për të sëmuret mendorë dhe përdoruesit e substancave narkotike, në të cilin ishin përfshirë mjeku, specialisti i kujdesit social dhe ai i regjimit të brendshëm. Ky program synonte trajtimin e diferencuar të këtyre grupeve të paraburgosurish në pozita të dobëta. Kjo nismë ka ardhur në vijim të ndihmesës dhe ekspertizës së dhënë nga KShH për trajtimin e diferencuar të personave në pozita të dobëta. Nga vëzhgimet e kryera mbetet ende shqetësues fakti që nuk realizohen ekzaminime mjekësore për të miturit në momentin e hyrjes së tyre në institucion. Mungesa e këtyre ekzaminimeve mjekësore nuk bën të mundur parandalimin dhe më pas trajtimin e patologjive të ndryshme sidomos të përdorimit të drogës nga të miturit, i cili është një fenomen gjithnjë në rritje, sidomos tek kjo grupmoshë.
Shërbimi stomatologjik në institucionet e vëzhguara mbetet ende problem sa i takon cilësisë së ofruar. Ndonëse kishte përmirësime, pasi tashmë kishte mjekë stomatolog me kohë të plotë, përveç se në Vlorë, kishte shumë mungesa të pajisjeve dhe medikamenteve stomatologjike. Ndonëse ishin siguruar pajisjet e shërbimit stomatologjik, mungesa e mjekut stomatolog në institucionin e Vlorës përbënte problem. Shpeshherë, ky shërbim kufizohej vetëm në heqje dhëmbësh dhe jo në mjekime të tjera të domosdoshme për shëndetin dentar. Falë ndërhyrjes së mëparshme

të KShH-së në institucionin e Lezhës ishte bërë i mundur hapja e kartelave stomatologjike për të miturit që në momentin e pranimit në institucion.

13. Informimi i të drejtave në momentin e ndalimit ose të arrestimit vazhdon të jetë problem shqetësues. Shumë prej të miturve të paraburgosur të intervistuar, pretendonin se nuk u ishin bërë të ditur të drejtat e tyre në momentin e arrestimit. Nuk u ishte vënë në dispozicion një avokat edhe pse e kishin kërkuar një të tillë. Në Qershor 2009, KShH dhe Avokati i Popullit ndërmorën një sondazh me të miturit e ardhur nga komisarite të ndryshme policie për të evidentuar rastet e keqtrajtmeve dhe përdorimit të torturës³. Kanë qenë shqetësuese përfundimet e këtij sondazhi pasi pothuajse të gjithë të miturit e intervistuar pohuan dhunë të ushtruar nga punonjësit e policisë dhe policisë gjyqësore në momentit e ndalim/arrestimit dhe marrjes në pyetje si edhe mohimin e të gjitha të drejtave procedurale të sanksionuara në legjislacionin shqiptar. Për më tepër, nga të gjithë të miturit u evidentua që edhe në rastet kur kjo dhunë ishte denoncuar nga i mituri në seancën gjyqësore ose tek prokurori, këto organe nuk kishin marrë asnjë masë për ndjekjen e rasteve dhe vënien përpara përgjegjesisë punonjësit e policisë që kishin ushtruar dhunë ndaj të miturve në fjalë. Këto konstatime janë tepër shqetësuese ndaj KShH-ja dhe Avokati i Popullit tërhoqi vëmendjen e autoriteteve përkatëse shtetërore për dhënien fund të ushtrimit të dhunës dhe rasteve të keqtrajtmeve nga ana e punonjësve të policisë dhe vënien menjëherë në lëvizje të organeve të prokurorisë dhe autoriteteve gjyqësore në rastet e denoncimeve.
14. Në përgjithësi rezultoi se nuk ka pasur raste flagrante të përdorimit të dhunës ndaj të miturve nga personeli i institucionit ku ata qëndronin. Kishte disa pretendime sporadike nga një i mitur në institucionin e paraburgimit 'Jordan Misja' Tiranë dhe nga disa të mitur në institucionin e Durrësit për ushtrim dhune nga punonjës të institucionit, të cilat ishin të vështira për t'u verifikuar. Megjithatë, pavarësisht këtij fakti KShH tërheq vëmendjen e drejtuesve të institucioneve penale dhe të DPB-së që të shqyrtojnë nga afër këto pretendime për parandalimin e rasteve të përdorimit të dhunës dhe të keqtrajtimit ndaj të miturve.
15. E drejta e informacionit dhe e ushtrimit të riteve fetare në institucionet e vëzhguara nga KShH-ja në përgjithësi zbatohet. Nga vëzhgimet rezultoi se të paraburgosurit/të dënuarit e mitur lejoheshin të informoheshin nëpërmjet medias vizive dhe të shkruar, bibliotekës së institucionit, si edhe nëpërmjet korrespondencës me letërkëmbim. Të miturve iu bëheshin prezent, në momentin e hyrjes në institucion, të drejtat dhe detyrimet që kanë gjatë qëndrimit aty.
16. Duke pasur parasysh rëndësinë e trajtimit nëpërmjet programeve psiko-sociale, edukuese dhe rikrijuese në grup dhe trajtimin individual, KShH i dha një rëndësi tejet të madhe vëzhgimit të programeve të ofruara në institucionet e vëzhguara. Vlen të theksohet se gjendja ndryshonte nga institucioni në institucion. Shembull pozitiv është vërejtur në institucionin e Vlorës, në të cilin kishte gjetur zbatim një program ditor i strukturuar dhe i larmishëm, jo vetëm për të miturit por për të gjitha kategoritë e të

³ Ky sondazh nuk është realizuar në kuadër të këtij projekti, por në kuadër të projekt 'Së bashku për trajtimin me respekt të të drejtave të personave të privuar nga liria', zbatuar nga KShH dhe financuar nga Komisioni Evropian. Përfundimet e tij po bëhen prezent edhe në këtë raport pasi trajtohen çështje të ndryshme të të drejtave dhe trajtimit të të miturve në konflikt me ligjin.

paraburgosurve që qëndronin aty. Në institucionin e Vlorës dhe të Lezhës funksionimin marrëveshje me Drejtoritë Rajonale përkatëse për t'i mundësuar të miturve në këto institucione realizimin e kurseve profesionale të pajisura me certifikatë. Nga vëzhgimet e kryera rezultoi se funksiononin bibliotekat, të cilat kishin nevojë të pajiseshin me libra të rinj, të përshtatshëm për grup mosha të ndryshme. Në këto institucione kryesisht realizoheshin kurse anglishteje dhe kompjuteri, përveç se në institucionin e Korçës në të cilin mungonin kompjuterat. Në institucionin e Korçës kishte një mungesë të theksuar të programeve, si dhe të aktiviteteve sportive e rikrijuese për të miturit. Mungesa e aktiviteteve sportive u evidentua edhe në institucionin e Durrësit. Pavarësisht mungesës së ambienteve të veçanta, nuk mund të justifikohet mungesa e aktiviteteve sportive qoftë një herë në javë për të miturit, apo e aktiviteteve të tjera rikrijuese të cilat janë një element i rëndësishëm i trajtimit të këtij grupi në institucionet penale.

17. Midis Ministrisë së Drejtësisë (MD) dhe Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës (MASH) ka një marrëveshje e cila mundëson bashkëpunimin e institucioneve penale dhe drejtorive arsimore nëpër rrethe sa i takon kryerjes së arsimit të detyruar 9 vjeçar për personat me liri të kufizuar. Deri tani, në institucionet e vëzhguara, kjo marrëveshje ka funksionuar vetëm në institucionin e Korçës, ndërsa në institucionet e Vlorës, Lezhës, Durrësit dhe 'Jordan Misjës' Tiranë kjo marrëveshje nuk ka gjetur ende zbatim. Në të ardhmen e afërt institucioni i Vlorës në bashkëpunim me qendrën Vatra, do të bënte të mundur arsimim për një periudhë 1 vjeçare të të miturve që qëndronin aty. Në institucionet e Lezhës dhe të Vlorës ishin vetë punonjësit e sektorit të kujdesit social që zhvillonin mësim me të miturit, ndërsa në institucionin e Durrësit realizoheshin kurse kundër analfabetizmit nëpërmjet ndihmesës së Kishës Katolike. Nga punonjësit e sektorit të kujdesit social të këtij institucioni u ngrit problemi i mospranimit të të miturve nëpër shkollat nga të cilat ata vinin, pas lirimit të tyre. Pavarësisht përpjekjeve të vazhdueshme nga ana e këtij institucioni, kjo gjë nuk kishte gjetur ende zbatim.
18. Vlen për t'u përmendur mbështetja e vazhdueshme dhe dhënia e ekspertizës nëpërmjet praktikave të mira nga KShH ndaj një pjese të personelit të sektorit të kujdesit social të institucioneve të ndryshme penale⁴. Si rezultat i këtyre trajnimeve janë trajnuar trajnerë lokalë të cilët, krahas vënies në zbatim të njohurive të marra duhej të realizonin trajnime të vazhdueshme dhe të planifikuara, kryesisht me personelin me uniformë që punon me të miturit dhe pjesën tjetër të këtij personeli. Nga vëzhgimet e kryera nuk rezultoi që institucionet të kenë plane të detajuara të këtyre trajnimeve. Gjatë periudhës së raportimit KShH ndoqi nga afër një trajnim të realizuar nga trajnerë lokalë të institucionit të Korçës ku u trajnuan personeli me uniformë. Vlen të theksohet se ky trajnim u realizua në bazë të kërkesës së bërë nga KShH për të parë nga afër këto lloj trajnimesh. Këto trajnime të personelit me uniformë janë tepër të rëndësishme për të kontribuar në krijimin e një atmosfere ku të miturit të ndihen të sigurt, e cili krijon kushtet për zhvillimin e të miturve dhe të aftësive të tyre sociale.

⁴ Janë realizuar 2 trajnime përkatësisht në Qershor 2007 dhe në Tetor 2009 në kuadër të projekteve të mbështetura nga Unicef, ku ekspertë nga burgjet holandeze kanë dhënë ekspertizë për çështje të rëndësishme sa i takon trajtimit të veçantë të të miturve. Pjesëmarrësit janë pajisur me module të veçantë trajnimi për trajtimin e të miturve dhe grave në institucionet penale.

19. Problem ende shqetësues ishte kohëzgjatja e takimeve, që sipas personave të intervistuar ishte e shkurtër. Të miturve iu krijohet mundësia e takimeve shtesë në raste të veçanta. Në institucionet e vëzhguara nuk kishte ambiente të veçanta për zhvillimin e takimeve me familjarët për personat e mitur, përveç institucionit të paraburgimit 'Jordan Misja' Tiranë, ku ka një ambient të veçantë për takime të tilla. Shqetësim tjetër i ngritur nga të miturit e intervistuar në lidhje me takimet me familjarët ishte fakti se të miturve nuk u krijohet mundësia e kontakteve fizike me familjarët e tyre. Kjo është situata në të gjitha institucionet e vëzhguara përveç institucionit të Vlorës, ku personeli kishte krijuar mundësi që të miturit të kenë kontakte fizike me familjarët gjatë takimeve të tyre. Duke pasur parasysh sesa e rëndësishme është lidhja me familjen për të miturit në institucionet penale, duhet të shihet me përparësi forcimi i kësaj lidhjeje që përfshin edhe takimet, ku të bëhet të mundura edhe kontaktet fizike me familjarët.

IV. Disa sugjerime për autoritetet e sistemit të burgjeve për përmirësimin e respektimit të të drejtave dhe trajtimit të të miturve

1. KShH vlerëson përmirësimin e kushteve fizike të institucioneve ku qëndrojnë të miturit, duke qenë se ato janë ndërtesa të reja, por vlerëson gjithashtu të rëndësishëm faktin se mungesa e ujit gjatë 24 orëve, e ngrohjes në disa institucione, si dhe ambienteve me lagështirë përbëjnë probleme të cilat pengojnë mbarëvajtjen e mirëfunksionimit të institucioneve penale. KShH sugjeron marrjen e masave në këtë drejtim, duke pasur parasysh se kushtet e mira infrastrukturore përbejnë premisat bazë për ofrimin e trajtimit të duhur për të miturit si edhe për kushtet e punës së personelit në këto institucione.
2. Lidhur me ajrimin në institucionet e vëzhguara, sidomos në institucionin e Korçës dhe në atë të Durrësit është e këshillueshme organizimi i ajrimit në kohë të ndryshme nga koha e ajrimit për të rritur. Është i këshillueshëm gjithashtu krijimi i kushteve të përshtatshme për ajrim në ambiente të hapura të mbrojtura në kushtet e motit me shi.
3. KShH vlerëson zbatimin e normës ushqimore në institucionet e vëzhguara, por sugjeron që DPB-ja të shohë mundësinë e ndalimit të praktikës së futjes së ushqimit ofruar nga familjarët duke ofruar alternativën e dyqaneve në institucion dhe arkëtimit të vlerave monetare nga familjarët për të miturit për t'i përdorur për blerje të artikujve të ndryshëm ushqimorë.
4. KShH vlerëson hapat pozitivë në drejtim të përmirësimit të shërbimit shëndetësor në institucionet e vëzhguara, por thekson edhe një herë se duhen marrë masat e nevojshme për realizimin e ekzaminimeve mjekësore në momentin e hyrjes së të miturve në institucion.
5. Shërbimit stomatologjik i duhet kushtuar më shumë vëmendje, duke qenë se është problem i konstatuar dhe i ri-ngritur disa herë nga vëzhgimet e KShH-së. Mungesa e mjekut stomatolog apo e pajisjeve të këtij shërbimi, çon në mosfunksionim të mirë të tij dhe për rrjedhojë në mos-përmbushjen e detyrimit të një shërbimi dentar në nivelet e duhura në këto institucione.
6. Duke pasur parasysh rëndësinë e vendosjes dhe forcimit të lidhjeve mes të miturve dhe familjarëve të tyre, drejtuesit e institucionit inkurajohen të krijojnë mundësitë dhe mjediset e nevojshme për takime në kushtet e një atmosfere të ngrohtë ku të krijohen mundësi të kontakteve fizike.
7. Ndryshimi i sjelljeve të të miturit dhe integrimi i tyre janë dy qëllimet kryesore të gjithë institucioneve penale që kanë nën kujdes të miturit. Duke pasur parasysh se u vunë re mungesa të theksuara të programeve që duhet të synojnë qëllimet e mësipërme në institucionet e vëzhguara, KShH sugjeron se drejtuesit e institucioneve dhe sidomos personeli i kujdesit social, duhet të planifikojnë dhe zbatojnë aktivitete të ndryshme që synojnë ndreqjen e sjelljeve të papranueshme sociale të të miturve dhe duhet të punojnë me planëzimin e dënimit të secilit të mitur, gjë që do të çojë në ri-integrimin e tyre në shoqëri pas lirisë.

8. Me ngritjen dhe funksionim e Shërbimit të Provës, KShH sugjeron DPB-së dhe institucioneve lokale të hartojnë programe pune të përbashkëta për përgatitjen e të miturve për lirim dhe ri-integrimin e tyre në shoqëri. Sugjerohet të përfshihen edhe prindërit e të miturve në këto programe ri-interimi.
9. Dhuna fizike dhe psikologjike duhet të parandalohet. Krahas rritjes se efektivitetit të kontrollit dhe të ndëshkimit të rasteve të keqtrajtimit, është e rekomandueshme organizimi sa më mirë i programeve ditore për të ulur stresin dhe situatën që mund të çojnë në tensione dhe cënime të rregullit. Gjithashtu, në rastet e pranimin të personave në institucion, është e detyrueshme të bëhet verifikimi i gjendjes fizike të personit dhe evidentimi i rasteve kur te personi ka shenja të përdorimit të dhunës ose pretendohet për përdorim dhune.
10. KShH vlerëson përpjekjet e DPB-së për ofrimin e arsimit të detyruar 9 vjeçar në disa institucione pilot, por sugjerojmë që ky shërbim të shtrihet në të gjitha institucionet penale.
11. Roli i punonjësve me uniformë në regjimet e brendshme është shumë i rëndësishëm në krijimin e një mjedisi të përshtatshëm për zhvillimin personal të të miturve. Duke pasur parasysh këtë rol KShH sugjeron që DPB-ja dhe trajnerët lokalë të institucioneve të planifikojnë trajnime të vazhdueshme me punonjësit me uniformë për çështje të ndryshme të rëndësishme për trajtimin human të të miturve.

Disa sugjerime për autoritetet e prokurorisë, gjyqësorit, policisë së shtetit dhe organeve të tjera publike

12. Duke pasur parasysh se mbetet shqetësuese gjendja në momentin e arrestimit dhe të ndalimit të të miturve, i kërkohet drejtuesve të policisë dhe prokurorisë të marrin masa që punonjësit e tyre të respektojnë detyrimin për informimin e të drejtave në momentin e ndalimit ose të arrestimit të një personi të mitur, të mos ushtrojnë dhunë fizike dhe psikologjike gjatë marrjes në pyetje të tyre, si dhe të zbatojnë detyrimin ligjor që gjatë marrjes në pyetje të të miturve të jetë prezent avokati, psikologu, prindi ose kujdestari i të miturit.
13. Megjithëse ka zhvillime pozitive kohët e fundit në dhënien e masave alternative të dënimit për të miturit, KShH sugjeron që të shihet interesi më i lartë i fëmijës në dhënien e masave të sigurisë ndaj tyre, pasi nga vëzhgimet e kryera rezulton se masa e sigurimit 'burg pa afat' nuk zbatohet gjithmonë si masë e fundit ndaj të miturve në konflikt me ligjin.
14. Ri-integrimi i të miturve në shoqërinë e lirë është përgjegjësi e gjithë organeve të dretësisë penale dhe organeve të tjera publike e sidomos atyre lokale si drejtoritë rajonale të arsimit, zyrat rajonale të punësimit, organet e qeverisjes vendore, zyrat lokale të shërbimit të provës etj., ndaj kërkohet një bahskëpunim më i mirë mes institucioneve penale dhe organeve të tjera që të arrihen rezultate për uljen e përsëritjes së krimit nga të miturit dhe rikthimin e tyre në shoqëri.